




Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Diaspora Shqiptare në botë (2020)



## PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2026-2030

**BASHKIA LEZHË**

*“...Të nderuar qytetarë të Lezhës,*

*Sot, me krenari dhe mirënjohje të thellë, përshëndes përzemërsisht këtë moment të rëndësishëm për qytetin tonë, kur miratojmë Planin Vendor për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030.*

*Ky plan përfaqëson një angazhim të fortë për të forcuar lidhjet me diasporën tonë dhe për të krijuar mundësi të reja zhvillimi për Lezhën.*




*E dimë se mijëra bashkëqytetarë tanë që jetojnë jashtë vendit vazhdojnë të ruajnë lidhje të ngushta me Lezhën dhe kontribuojnë në shumë mënyra. Ky plan është një mundësi për të përfutur nga kjo energji pozitive, për të mbështetur investimet, për të nxitur kthimin e të rinjve dhe për të ruajtur e promovuar trashëgiminë tonë kulturore të pasur.*

*Një falënderim i veçantë për të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin dhe miratimin e këtij plani.*

*Ju ftoj të gjithëve që të bashkohemi në zbatimin e tij, duke ndërtuar një të ardhme më të mirë për qytetin tonë të dashur.*

*Suksese në këtë rrugëtim që kemi përpara!...”*



# PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2026-2030

## BASHKIA LEZHË

*Plani Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030 me mbështetjen e Programit “Formimi i Migrimit të Orientuar drejt Zhvillimit”, i financuar nga Qeveria Gjermane dhe i zbatuar nga GIZ-Shqipëri.*

*Në procesin e hartimit dhe konsultimit të Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën u anagzhua grupi i punës si më poshtë,*

### Grupi i punës:

1. Brikena Vuksani Kryetar grupi, me detyrë Zv/Kryetar në Bashkinë Lezhë
2. Vasilika Laska Koordinator, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diaporës, Komunikimit dhe Transparencë

3. Marte Fetaj Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social
4. Altin Lleshi Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike
5. Jetmira Leka Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
6. Keler Sufja Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve
7. Denis Përvathi Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore
8. Renaldo Xhanej Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Turizmit
9. Flamur Kuçi Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban
10. Mariolina Lleshi Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Finanës dhe Buxhetit
11. Jurgen Marku Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit
12. Valmira Guzi Ekspert – Key Adviser
13. Arbi Basho Ekspert – Key Adviser
14. Mariel Hysa Ekspert – Key Adviser

## **PËRMBAJTJA**

LISTA E SHKURTIMEVE .....	IV
LISTA E TABELAVE.....	V
HYRJE .....	1
METODOLOGJIA .....	2
KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBETAR .....	6
PLANET VENDORE TË BASHKISË Lezhë .....	13
PROFILI I BASHKISË Lezhë.....	15
PERSPEKTIVA GJINORE .....	17
ANALIZA PESTEL.....	20
OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR Lezhë.....	27
FUSHA E VEPRIMIT A .....	28
FUSHA E VEPRIMIT B .....	33
FUSHA E VEPRIMIT C .....	36
MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT .....	38
FORMATET E RAPORTIMIT .....	47

## LISTA E SHKURTIMEVE

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BL	Bashkia Lezhë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHBD	Dhoma e Biznesit të Diasporës
DKM	Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit
GCM	Kompakti Global për Migracionin
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
MB	Ministria e Brendshme
MPV	Ministri për Pushtetin Vendor
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
SDG	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel Migracioni
SMD	Struktura e Migracionit dhe Diasporës

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Analiza PESTEL.....	20
Tabela 2: Objektivat e Planit Vendor Lezhë.....	27
Tabela 3: Fusha e Veprimit A.....	31
Tabela 4: Fusha e Veprimit B.....	34
Tabela 5: Fusha e Veprimit C.....	37
Tabela 6: Monitorimi i Planit të Veprimit.....	39
Tabela 7: Formati i Raportimit të Planit të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030, Bashkia Lezhë.....	47

## **HYRJE**

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën në bashkinë Lezhë u realizua në kuadër të Programit të GIZ (MEG) **“Fuqizimi i Politikave për Orientimin e Migracionit drejt Zhvillimit”**, i mbështetur financiarisht nga Qeveria Gjermane. Ky plan është bazuar në ligjin kombëtar dhe lokal, si dhe në udhëzimet për planifikimin e territorit të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Ndryshimet në ligjin për vetëqeverisjen vendore në vitin 2015 dhe në vitin 2019, adresojnë nevojën për hartimin e këtij plani, duke e bërë atë një element shtesë për qeverisjen e bashkisë Lezhë, duke përfshirë migracionin dhe diasporën në procesin e planifikimit, veprimit dhe monitorimit të projekteve dhe planeve që lidhen me ta. Ndër të tjera, ndryshimet në ligjin për vetëqeverisjen vendore kanë përcaktuar dhe shtuar detyrat dhe funksionet e bashkive në lidhje me diasporën dhe migracionin, duke thelluar përgjegjësitë e tyre për këto çështje të nivelit lokal:

- a) Krijimi i një strukture të specializuar për menaxhimin e shërbimeve të diasporës dhe migracionit në nivel lokal, si pjesë e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b) Inkurajimi i organizatave brenda dhe jashtë vendit për të ruajtur komunikimin dhe forcimin e lidhjeve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;
- c) Ofrimi i ndihmës dhe informacionit për procesin e fitimit të shtetësisë shqiptare;
- d) Furnizimi me ndihmë dhe informacion për interesuarit nga diaspora dhe migracioni rreth legjislacionit shqiptar për investimet, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për investimet;
- e) Koordinimi me ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, të jashtme dhe për diasporën për sigurimin e ndihmës dhe informacionit për çështjet lidhur me diasporën dhe migracionin.

Nëpërmjet këtyre masave dhe politikave, synohet të krijohen struktura funksionale dhe politika të përshtatshme për menaxhimin e migracionit dhe statusit të diasporës shqiptare në botë, duke thelluar ndërveprimin e tyre në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Kjo sjell përfshirjen e diasporës në procesin e planifikimit të nivelit lokal dhe hartimin e një manuali me objektiva dhe masa strategjike për këtë qëllim, duke përcaktuar rolin e aktorëve të interesuar në fushën e migracionit dhe diasporës.

## **METODOLOGJIA**

Metodologjia e përdorur në procesin e hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën përfshin disa hapa dhe procese kryesore në vetvete. Kjo metodologji e ndjekur siguron bashkëpunimin me ministritë, agjencitë dhe njësitë e qeverisjes vendore duke nxitur pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të dinamikës së migracionit dhe procesit të planifikimit. Duke përcaktuar metodologjinë dhe objektivat e qarta, synohet të arrihet një qasje sistematike dhe efektive për adresimin dhe shfrytëzimin e sfidave të migracionit dhe mundësitë në nivel lokal. Metodologjia mbështetet në tre shtylla kryesore si:

**Analiza dhe vlerësimi i nevojave dhe potencialit të komunitetit për të identifikuar sfidat dhe përcaktuar mundësitë për diasporën dhe migracionin sipas nevojave reale të bashkisë, realizohet përmes:**

- Mbledhjes së të dhënave nga burime të ndryshme, përfshirë pikat e migracionit pranë Agjencive Rajonale të Punësimit dhe Aftësive, institucionet publike, vizitat në terren, intervistat dhe konsultimet me banorë, migrantë të kthyer dhe diasporën.
- Përmbledhjes së dokumenteve dhe politikave në nivel vendor dhe kombëtar për të identifikuar trendet aktuale dhe qëndrimet ndaj migracionit, si dhe harmoninë e tyre me standardet ndërkombëtare.
- Analizës së praktikave më të mira, duke shqyrtuar përvoja kombëtare dhe ndërkombëtare për kthimin dhe riintegrimin e migrantëve, veçanërisht shembujt nga vendet e rajonit për përmirësimin e qasjes në Shqipëri.

**Përfshirja e aktorëve lokalë dhe Diasporës në një proces konsultativ për Hartimin e Planit të Veprimit, përmes:**

- Tryezave të rumbullakëta dhe takimeve me përfaqësues të bashkisë, komunitetit, bizneseve dhe diasporës për të diskutuar nevojat, mundësitë dhe strategjitë e përbashkëta.
- Krijimit të kanaleve të dedikuara komunikimi për të nxitur përfshirjen e diasporës në projekte zhvillimore në Lezhë, duke lehtësuar investimet, ndarjen e ekspertizës dhe ndërveprimin e vazhdueshëm me komunitetin lokal.

**Studimi i kuadrit strategjik, ligjor dhe institucional për Migracionin dhe Diasporën, për të siguruar që plani të jetë në përputhje me legjislacionin dhe strategjitë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes:**

- Shqyrtimit të politikave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përshtatshmërisë së tyre në nivel lokal, për një qasje të qëndrueshme dhe të unifikuar.
- Analizës së detyrimeve ligjore dhe integritit të tyre në politikat lokale për të siguruar përputhshmëri me kërkesat ligjore.

**Vendosja e objektivave të qarta dhe të matshme për të nxitur zhvillimin e Bashkisë, duke siguruar ndikim të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë, me fokus në 8/477kthimin e migrantëve, përfshirjen e diasporës dhe forcimin e kapaciteteve lokale, përmes:**

- Përcaktimit të objektivave kryesore: Vendosja e synimeve specifike për kthimin e migrantëve, përfshirjen e diasporës në projekte dhe investime lokale, si dhe përmirësimin e aftësive të strukturave vendore për të menaxhuar zhvillimin.
- Zhvillimit të masave konkrete: Krijimi i një plani veprimi me masa të qarta, afate dhe përgjegjësi të ndara, për të zbatuar objektivat me përfshirjen e aktorëve lokalë dhe të diasporës, të matshme dhe të monitorueshme për progres të vazhdueshëm.

**Iniciativa për forcimin e kapaciteteve të stafit lokal dhe grupeve të punës për pjesëmarrje aktive dhe zbatim efektiv të planit të veprimit përmes:**

- Trajnimeve të strukturuar për t'i pajisur zyrtarët me aftësi praktike për të përmbushur rolet e tyre dhe për të përballuar sfidat e migracionit, përfshirjes së diasporës dhe zhvillimit ekonomik.
- Angazhimit të grupeve të punës, përbërë nga përfaqësues të bashkisë dhe aktorë lokalë, për të ndjekur dhe drejtuar zbatimin e planit, duke mbështetur bashkëpunimin me komunitetin dhe diasporën për monitorim dhe reagim të vazhdueshëm ndaj ndryshimeve.

**Metodat e përdorura:**

**Krijimi i një grupi pune** për hartimin dhe konsultimin e planit me specialistë të migracionit dhe diasporës, ekspertë ligjorë, specialistë të financave dhe përfaqësues nga sektori social dhe kulturor, për të garantuar një strukturë të qëndrueshme dhe të përshtatur për nevojat e Bashkisë dhe komunitetit.

**Fokus Grupet:** Këto grupe diskutimi mbledhin informacione nga institucionet publike lokale

për të dakordësuar fushat kryesore të veprimit, objektivat dhe masat që do të përfshihen në plan.



**Dialogu Shumë-Palësh** i organizuar nga Key Adviser dhe GIZ (MEG) u fokusua në mbështetjen e Bashkive për zhvillimin e Planeve Lokale të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën. Përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor,

Bashkitë, AKPA, dhe sektori privat ishin të pranishëm në këtë aktivitet shumëdimensional. Key Adviser mbështeti konkretisht Bashkinë Lezhë në këtë process për hapat e parë në hartimin e planit lokal të migracionit dhe diasporës.

**Workshop dhe Trajnime:** Objekti kryesor i këtyre workshop-ve ishte shqyrtimi dhe përmirësimi i planeve draft për Bashkinë Lezhë, me fokus në forcimin e masave konkrete sipas kontekstit lokal për angazhimin e migracionit dhe diasporës si dhe për të rritur bashkëpunimin mes ekipit të ekspertëve dhe grupit të punës.



Po ashtu **organizimi i sesioneve të trajnimit** për përfaqësuesit lokalë të Bashkisë Lezhë ka si



qëllim përmirësimin e aftësive, rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre në lidhje me hartimin dhe zbatimin efektiv të objektivave të planifikuara. Këto aktivitete janë të domosdoshme për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara.

**Konsultim me Bashki të tjera:** Shkëmbimi i përvojave me bashki si Shkodra, Kukësi, Dibra, Elbasani dhe Korça, për të mësuar nga praktikat e tyre në hartimin e planeve për migracionin dhe diasporën.

**Konsultimi Publik:** Në përfundim, plani do të kalojë përmes një konsultimi publik për të siguruar pjesëmarrjen dhe kontributin e komunitetit dhe palëve të tjera në finalizimin e Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën.

## KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR

Në spektrin ndërkombëtar Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në fushën e migracionit duke adoptuar **Marrëveshjen Globale për Migracionin (GCM)** në dhjetor 2018, gjatë Konventës Ndërqeveritare në Marrakesh, e cila synon të lehtësojë lëvizjen e sigurt të migrantëve dhe të maksimizojë përfitimet që ata sjellin. Qeveria shqiptare ka integruar GCM-në në politikat e saj të migracionit dhe ka dorëzuar një raport vlerësimi për periudhën 2019-2021, po ashtu ka hartuar raporte për rishikimin rajonal dhe kombëtar të GCM-së në vitet 2020 dhe 2022, duke e vlerësuar anëtarësimin në Bashkimin Evropian si një prioritet kyç për zhvillimin e vendit.

Përmes **Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe Planit të Veprimit 2024-2030**, Shqipëria synon të përmirësojë koherencën ndërmjet politikave dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm, shtuar faktin që Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ofron udhëzime të vazhdueshme për zbatimin e GCM-së, duke nënvizuar lidhjen me SKM-në. Në këtë kontekst, një nga sfidat kryesore vazhdon të mbetet promovimi i kthimit vullnetar të migrantëve, që konsiderohet një mënyrë efektive për të parandaluar migrimin e të kualifikuarve. Kthimi dhe riintegrimi i të miturve të pashoqëruar dhe të kthyer në rrethana të cenueshme janë gjithashtu detyra të rëndësishme, me qëllim për të parandaluar keqpërdorimin e regjimit pa viza dhe për të ulur kërkesat për azil në Bashkimin Evropian, janë të nevojshme masa urgjente dhe konkrete. Një prioritet tjetër është përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e flukseve të migracionit, duke krijuar hapësira adekuate për të miturit, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikimit ku Ministria e Brendshme, përmes Departamentit të Antitrafikimit dhe Migracionit, është e angazhuar për të informuar vazhdimisht institucionet dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm. Për të përmirësuar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit (2024-2030), është e rëndësishme që të krijohen mekanizma efektivë për konsultime të rregullta me palët e interesuara. Këto konsultime do të ndihmojnë në identifikimin e nevojave dhe sfidave që hasin ata që kërkojnë strehim dhe mbështetje, duke u siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh në procesin e vendimmarrjes.

Duke u mbështetur në parimet e **Kompaktit Global për Refugjatët**, Shqipëria duhet të angazhohet për të forcuar bashkëpunimin me vendet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, për të siguruar një ndarje të drejtë të barrës dhe përgjegjësisë në trajtimin e krizave të migracionit. Iniciativat për rritjen e kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për refugjatët dhe migrantët do të jenë thelbësore. Kjo do të përfshijë trajnimet për punonjësit e shërbimeve sociale, ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe sociale,

si dhe integrimin e refugjatëve në komunitetet lokale. Angazhimi i Shqipërisë në Forumin e Parë Global të Refugjatëve në 2019, dhe përfshirja e vazhdueshme për të adresuar sfidat e migracionit, tregon se vendi është në rrugën e duhur për të ndihmuar ata që janë në nevojë dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Me një qasje të koordinuar dhe proaktive, Shqipëria mund të shërbejë si një model në menaxhimin e migracionit dhe mbështetje të refugjatëve në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar. Në përgjigje të kësaj në shkurt të 2021, qeveria shqiptare miratoi **një ligj të ri për azilin**, i cili shënon një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të sistemit të azilit me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian. Ky ligj parashikon zhvillimin e një mekanizmi nga Ministria e Brendshme për vlerësimin e proceseve të azilit dhe përmirësimin e cilësisë së procedurave, duke bashkëpunuar ngushtë me UNHCR. Një aspekt kyç i këtij procesi është organizimi i trajnimeve për zyrtarët e azilit në bashkëpunim me EUAA, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit në trajtimin e kërkesave për azil.

Për më tepër, **strategjia e Bashkimit Evropian për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin**, e publikuar në prill 2021, thekson rëndësinë e krijimit të një sistemi të përbashkët për menaxhimin e kthimeve dhe riintegrimi vullnetar të migrantëve. Kjo strategji fokusohet në forcimin e shërbimeve publike në vendet e origjinës, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe mundësitë për punësim, duke e bërë riintegrimin më të suksesshëm. Bashkëpunimi ndërkombëtar, angazhimi i shoqërisë civile dhe përfshirja e sektorit privat janë thelbësore për arritjen e këtyre objektivave. Agjencia Frontex po ashtu është angazhuar të mbështesë këtë proces, duke dërguar oficerë ndërlidhës në vendet e treta për të organizuar ripranimin e migrantëve dhe për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve vendore.

Qeveria shqiptare ka shprehur angazhimin e saj për të harmonizuar politikat kombëtare me ato të BE-së përmes **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030**. Kjo strategji përfshin prioritete për migracionin që përputhen me paktin e BE-së, me një fokus të veçantë në tërheqjen e migrantëve shqiptarë dhe lehtësimin e riintegrimit të tyre. Gjatë Samitit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, u diskutua gjithashtu për Planin e Veprimit të BE-së, i cili përmban 20 masa operationale për forcimin e menaxhimit të kufijve, procedurat e shpejta të azilit dhe luftimin e kontrabandës së migrantëve.

Qeveria shqiptare ka integruar këto masa në **Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe Planin e Veprimit 2024-2030**, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për menaxhimin e migracionit të sigurt dhe të rregullt. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2023 konfirmon se kuadri ligjor për migracionin është gjerësisht në

përputhje me *acquis* të BE-së, duke dëshmuar angazhimin e vendit për të përmirësuar sistemin e tij të menaxhimit të migracionit dhe për të siguruar një mbështetje efektive për ata që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Këto nisma përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në rrugën e Shqipërisë drejt integrimit në Bashkimin Evropian dhe ofrojnë një perspektivë më të mirë për migrantët dhe ata që kërkojnë azil. Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe BE-së për zbatimin e Planit të Veprimit për Ballkanin Perëndimor ka sjellë rezultate të dukshme. Shqipëria ka finalizuar një Marrëveshje të rishikuar me Frontex-in, duke përafuar 26 nga 29 aktet legislative të nevojshme. Megjithatë, sfidat mbeten, sidomos në lidhje me kthimin e shtetasve të vendeve të treta, që është ende në nivele të ulëta. Policia e Kufirit dhe Migracionit ka nevojë të krijojë struktura trajnuese për identifikimin e grupeve vulnerabël dhe të forcojë koordinimin me departamentet e antitrafikut dhe mbrojtjes së fëmijëve. Në fushën e azilit, Shqipëria ka përafuar 15 akte legislative, por konsultimet me EUAA vazhdojnë të mbeten thelbësore për përmirësimin e procesit. Rritja e kërkesave për azil nga shqiptarët në vendet e BE-së tregon nevojën për masa ri-integrimi, veçanërisht për ata që janë më në nevojë.

Raporti gjithashtu evidenton progresin në lirinë e lëvizjes, me një rënie të refuzimeve në pikat kufitare. Në aspektin e kuadrit kombëtar janë një sërë dokumentash strategjike që përputhen dhe përkojnë me masat dhe objektivat e planit të veprimit si, **Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2021-2025** që janë korniza strategjike për mbështetje ndaj shqiptarëve jashtë atdheut. Qëllimi kryesor është hartimi i politikave gjithëpërfshirëse për komunitetet shqiptare, duke siguruar angazhim dhe mbështetje ligjore. Strategjia promovon integrimin dhe kontributin e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë. Ajo synon të fuqizojë lidhjet mes shqiptarëve në mbarë botën dhe të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve dhe vendit. Plani i veprimit përforcon politikën lokale për të krijuar një bashkëpunim të qëndrueshëm.

Një tjetër dokument që përkon me objektivat dhe masat e planit të veprimit është **Strategjia Kombëtare e Migracionit dhe Plani i Veprimit 2024-2030** synojnë të koordinojnë aktivitetet e institucioneve për të arritur objektivat e politikave migratore. Fokusohen në zhvillimin e politikave efektive që promovojnë ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik. Dokumenti përfshin masa për lehtësimin e procedurave për leje unike, shërbime integrimi dhe riintegrim të emigrantëve. Rëndësi i jepet krijimit të mekanizmave koordinues në të gjitha nivelet e qeverisjes, sidomos në nivelin lokal.

Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve nga

migracioni dhe ndikimin e qëndrueshëm në ekonomi, sakaq **Strategjia Kombëtare e Punësimit 2023-2030** në Shqipëri adreson sfidat e punësimit përmes pesë qëllimeve kryesore si: reduktimi i mospërputhjeve të aftësive, rritja e niveleve të aftësive për të dyja gjinitë, përmirësimi i vlerave të punës, dixhitalizimi i mbështetjes për punësim dhe sigurimi i funksionimit të saktë dhe në kohë të masave. Ajo gjithashtu fokusohet në integrimin social dhe territorial, duke adresuar sfidat e migracionit dhe diasporës me një qasje të personalizuar. Kjo strategji ofron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi në Shqipëri.

Një dokument tjetër që korespondon me qëllimet dhe masat e planit të veprimit është **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021-2027** që thekson rëndësinë e diasporës shqiptare për rritjen ekonomike të vendit. Ajo nxit angazhimin e diasporës në aktivitete ekonomike dhe promovon nisma sipërmarrëse, duke krijuar një kuadër ligjor që lehtëson investimet. Qëllimi është forcimi i lidhjeve brenda komunitetit shqiptar dhe shfrytëzimi i potencialit të diasporës si burim për zhvillimin ekonomik. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon krijimin e një ambienti miqësor për bashkëpunim dhe përmbushjen e nevojave lokale për investime nga diaspora.

Arsimi në Republikën e Shqipërisë menaxhohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas **Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe Planit të Veprimit 2021-2026**. Këto dokumente adresojnë sfidat e arsimit duke përcaktuar përgjegjësitë midis Ministrisë së Arsimit dhe njësieve lokale të vetëqeverisjes vendore. Ato kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, veçanërisht në sistemin e arsimit parashkollor. Strategjia thekson mbështetje për fëmijët në rrezik, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe minoritetet. Po ashtu, në kuadër të planit për Migracionin dhe Diasporën, fokusohet në ofrimin e informacionit dhe mbështetje për rikthyerit dhe të huajt, për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri. Një tjetër shërbim thelbësor që ofrohet në njësitë e vetëqeverisjes vendore është shërbimi shëndetësor.

**Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030** synon të sigurojë zbatimin efektiv të nismave shëndetësore në nivel kombëtar përmes një bashkëpunimi të ngushtë me aktorë të ndryshëm, si ministritë dhe përfaqësuesit vendor. Kjo strategji ofron një kornizë të qartë për koordinimin dhe mbështetje për ata që përballen me sfida të veçanta, siç janë ata që rikthehen nga emigracioni dhe të huajt. Ajo garanton akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor në nivel lokal, duke siguruar që çdo individ të ketë mundësi për të përfituar nga shërbimet e nevojshme.

Në këtë mënyrë, strategjia kontribuon në një mirëqënie më të plotë të popullsisë, duke adresuar nevojat unike të grupeve të ndryshme dhe duke krijuar një sistem shëndetësor më të integruar dhe të aksesueshëm për të gjithë përfshirë të huajt që jetojnë në Shqipëri. Ndërkohe një aspekt tjetër më largpamës thekson rëndësinë që ka.

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030** në Shqipëri paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila ndërtohet mbi sukseset e strategjisë së mëparshme (2015-2020). Ajo fokusohet në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe aspiratave për anëtarësim në Bashkimin European. Kjo strategji angazhon institucione të ndryshme, duke siguruar një koordinim të efektshëm në procesin e zhvillimit dhe integritit të vendit. Gjithashtu, Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon të krijojë një sistem të fuqishëm qeverisjeje për menaxhimin e migracionit, duke adresuar sfidat përkatëse dhe duke theksuar rëndësinë e tij për zhvillimin kombëtar.

Pa dyshim, që rinia është e ardhmja e çdo kombi, dhe **Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029** synon të fuqizojë të rinjtë në Shqipëri, duke i inkurajuar ata të angazhohen aktivisht në shoqëri dhe në proceset vendimmarrëse. Kjo strategji përfshin politika të informuara dhe të mirëfinancuara, të cilat promovojnë mundësi arsimore dhe zhvillimin e aftësive në një kontekst global. Një fokus i veçantë i saj është adresimi i nevojave të grupeve vulnerabël, si studentët e huaj dhe ata që janë kthyer nga emigracioni. Qëllimi është të krijohet një kuadër gjithëpërfshirës që siguron zhvillimin dhe mirëqenien e të rinjve, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive dhe integrimin në tregun e punës. Kjo do të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të qëndrueshme, ku çdo i ri ndjen se ka një rol të rëndësishëm në formësimin e të ardhmes së vendit të tij.

Një rëndësi të padiskutueshme ka **Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030** e cila paraqet një bazë të fortë për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve më afër qytetarëve duke theksuar rëndësinë e njësisë të vetëqeverisjes vendore në sigurimin e qeverisjes së mirë, duke përmirësuar shërbimet për komunitetet. Reforma administrative ka sjellë decentralizim të funksioneve, duke i lejuar bashkive të operojnë në mënyrë demokratike dhe të adresojnë nevojat specifike të komuniteteve të tyre. Qëllimi kryesor i strategjisë është konsolidimi i procesit të decentralizimit, me fokus në zhvillimin ekonomik lokal të qëndrueshëm, duke ofruar shërbime cilësore dhe transparente. Përmes rritjes së kapaciteteve për menaxhimin e aseteve, digjitalizimit të shërbimeve dhe forcimit të autonomisë financiare, strategjia synon të

përmirësojë efikasitetin e qeverisjes vendore. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën gjithashtu përfshin masa për të siguruar akses më të mirë në shërbime për grupet e cënueshme, duke integruar aspektet e migracionit në zhvillimin lokal, për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Një tjetër dokument është **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030** synon zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e jetesës për individët në nevojë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe grupe vulnerabël. Ajo promovon skema financiare të qëndrueshme për fuqizimin dhe integrimin e këtyre individëve përfshirë të huajtë. Strategjia fokusohet në qasjen e barabartë në shërbime sociale dhe zhvillimin e aftësive për integrim në tregun e punës. Masa konkrete mbështesin riintegrimin social-ekonomik, duke lidhur punësimin me promovimin e ndërmarrjeve sociale dhe janë në harmoni me planin për Migracionin dhe Diasporën.

Një rëndësi të vecantë, për vetë faktin se integrimi gjinor vazhdon të mbetet një çështje e nxehte dhe e diskutueshme, paraqet dhe **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030** që është një iniciativë kyçe për promovimin e të drejtave të grave dhe reduktimin e diskriminimit gjinor. E hartuar në bashkëpunim me institucione të ndryshme, ajo fokusohet në garantimin e të drejtave ekonomike dhe sociale për të gjitha grupet, pa dallim gjinie. Strategjia inkurajon trajtimin e barabartë në shërbime dhe aksesin në teknologji, duke siguruar mundësi të barabarta për zhvillim ekonomik. Në kuadër të planit të veprimit për Migracionin dhe Diasporën, theksohet rëndësia e barazisë gjinore për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke krijuar një ambient të drejtë për të gjithë individët në shoqëri.

Një aspekt tjetër që lidhet prek drejtpërdrejt nivelin lokal është dhe **ligji për Vetëqeverisjen Vendore nr. 139/2015**, së bashku me ndryshimet e **ligjit nr. 38/2019**, ka sjellë një transformim të rëndësishëm në organizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, duke u fokusuar në decentralizimin dhe efikasitetin e administratës publike. Një element thelbësor është angazhimi me diasporën dhe komunitetet e migrantëve, ku bashkitë tani kanë përgjegjësi të qarta për këto grupe. Struktura të posaçme adresojnë shqetësimet e të rikthyerve dhe emigrantëve, ofrojnë asistencë dhe informacion mbi legjislacionin e investimeve, si dhe krijojnë mundësi integrimi, duke forcuar lidhjet midis shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Kjo kontribuon në forcimin e komuniteteve dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë.

Një ligj që prek drejtpërdrejt kategorinë e të huajve në Shqipëri është **"Ligji për Të Huajt" nr 79 / 2021** që është një dokument i rëndësishëm që rregullon mënyrën se si individët e huaj hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga vendi. Ai përfshin aspekte kyçe si lëshimi i vizave dhe lejeve

të qëndrimit, duke mbështetur parime themelore si interesi më i mirë i fëmijëve, uniteti familjar dhe mosdiskriminimi. Ky ligj zbatohet për të huajt që vijnë në Shqipëri për arsye punësimi, studimi ose qëndrimi, duke përcaktuar në mënyrë të qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe ato të autoriteteve përkatëse. Me avancimin e procesit të dixhitalizimit, aplikimet për vizat dhe lejet e qëndrimit tani janë bërë më të thjeshta dhe më të aksesueshme, pasi mund të realizohen online. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ata që hasin vështirësi për shkak të mungesës së misioneve diplomatike në disa vende. Gjithashtu, ligji përfshin nisma për integrimin e migrantëve, duke ofruar shërbime dhe programe arsimore që ndihmojnë ata në orientimin në sistemin institucional shqiptar. Kjo qasje e integruar jo vetëm që përmirëson aksesin në shërbime thelbësore, por gjithashtu nxit një integrim të suksesshëm të të huajve në shoqërinë shqiptare. Duke siguruar mbështetje dhe burime, ligji respekton të drejtat e njeriut dhe kontribuon në krijimin e një ambienti më mikpritës për të gjithë ata që zgjedhin Shqipërinë si vend të tyre të ri.

## **PLANET VENDORE TË BASHKISË LEZHË**

### **Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunitetit të Lezhës (2013-2030)**

përbën një vizion të qartë dhe të angazhuar për promovimin e kulturës dhe traditave lokale në këtë rajon të pasur. Bashkia Lezhë ka organizuar një sërë aktiviteteve kulturore gjatë gjithë vitit, me qëllim që të forcojë angazhimin e komunitetit dhe të festojë trashëgiminë kulturore që e karakterizon. Këto iniciativa kulturore janë krijuar për të nxitur një ndjenjë përkatësie dhe krenarie tek banorët, duke theksuar gjithashtu vlerat dhe historinë e pasur të rajonit. Në përputhje me objektivat e përcaktuara në planin strategjik, Bashkia Lezhë pret një kalendar të pasur me ngjarje kulturore, përfshirë festime që lidhen me ritin e kalendarit dhe ngjarje të rëndësishme sezonale. Një shembull i shkëlqyer i këtyre festimeve është kulminimi i periudhës së dimrit me Natën e Nderuar të Buzzard, e cila festohet më 24 dhjetor. Kjo është një mundësi për t'u bashkuar si komunitet dhe për të shprehur mirënjohje ndaj traditave që na lidhin me natyrën dhe ciklet e saj. Për më tepër, Dita e Verës, Dita e Shën Gjergjit (6 maj), Dita e Shën Gjinit (24 qershor), si dhe ngjarje të tjera kulturore, shënojnë momente të rëndësishme që na bashkojnë dhe na mbushin me frymëzim. Një nga nismat më të veçanta është shpallja e 15 gushtit si "Dita e Emigrantëve" e cila është festuar që nga viti 2007. Kjo ditë është e dedikuar për nderimin e emigrantëve nga qyteti, duke njohur kontributet e tyre të çmuara për komunitetin dhe përvojat e tyre të çmuara jashtë vendit. Me këtë rast, Bashkia Lezhë tregon përkushtimin e saj për të forcuar lidhjet me diasporën dhe për të promovuar një ndjenjë uniteti që tejkalon kufijtë gjeografikë. Këto aktivitete kulturore jo vetëm që festojnë traditat e pasura, por gjithashtu forcojnë identitetin lokal dhe ndihmojnë në krijimin e një komuniteti të qëndrueshëm dhe të angazhuar. Bashkia Lezhë është e angazhuar të vazhdojë të organizojë dhe mbështesë këto ngjarje, duke e bërë kulturën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të saj të qëndrueshëm.

**Plani Social i Bashkisë Lezhë 2022-2025** përfshin dy masa kyçe që adresojnë nevojat e migrantëve të kthyer dhe të mundshëm, me fokus të veçantë në fëmijët dhe familjet që janë prekur nga migrimi. Këto masa kanë si synim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mbështetje të qëndrueshme për individët e prekur. Përmirësimi i kushteve të jetesës për fëmijët migrantë në Shqipëri është një nga masat kryesore. Kjo masë është e orientuar drejt identifikimit dhe adresimit të sfidave specifike me të cilat përballen fëmijët që kanë emigruar ose janë ndikuar nga migrimi. Ajo përfshin krijimin e programeve që ofrojnë mbështetje të përshtatur për nevojat e tyre, si edukimi, shëndeti dhe integrimi social. Qëllimi është të sigurohet një mjedis mbështetës që nxit zhvillimin e tyre të plotë dhe kontribuon në mirëqenien

e tyre. Mbështetja e familjeve, fëmijëve dhe të rinjve të ekspozuar ndaj migrimit është masa tjetër kyçe që përfshin bashkëpunimin me organizata të njohura si Terre des Hommes dhe World Vision. Kjo masë synon të ofrojë një gamë shërbimesh për familjet dhe individët që janë të prekur nga migrimi, duke adresuar nevojat socio-ekonomike, arsimore dhe psikosociale. Nëpërmjet këtyre përpjekjeve, synohet ndihma për rritjen e elasticitetit të këtyre individëve dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre. Një nga nismat e rëndësishme në këtë drejtim është ngritja e Qendrës Komunitare për Përmirësimin e Jetës për fëmijët dhe familjet e kthyer nga emigrimi, në bashkëpunim me Terre des Hommes dhe World Vision. Kjo qendër ofron një gamë të gjerë shërbimesh, të cilat përfshijnë fuqizimin ekonomik, mbrojtjen e fëmijëve në nevojë, këshillimin për prindërim pozitiv, mbështetje psiko-sociale përmes aktiviteteve dhe lojërave, si dhe ndihmë për integrimin në sistemin arsimor. Këto masa bashkëpunuese janë të rëndësishme për të krijuar një mjedis më të mirë për fëmijët dhe familjet e prekura nga migrimi, duke kontribuar në një shoqëri më të integruar dhe të qëndrueshme. Ato janë një hap i rëndësishëm drejt ndihmës dhe mbështetjes për ata që janë në nevojë, duke krijuar mundësi për një të ardhme më të ndritur dhe të sigurt.

## PROFILI I BASHKISË LEZHË

Bashkia Lezhë, e cila është një nga bashkitë më të njohura të Shqipërisë, ndodhet në një pozitë strategjike dhe ofron një kombinim të bukur të peisazheve natyrore dhe kulturës historike. Rrethi i Lezhës përfshin gjithashtu rrethet e Kurbinit dhe Mirditës, duke ofruar një diversitet të gjerë kulturor dhe natyror. Sipërfaqja totale e Bashkisë është 509.1 km<sup>2</sup>, duke e bërë atë një nga bashkitë më të mëdha në Shqipëri. Territori i qarkut të Lezhës është një nga zonat



më të veçanta dhe piktoreske të Shqipërisë. Ky rajon shtrihet në një përzierje magjepsëse të krahinës malore-qendrore dhe ultësirës perëndimore, duke ofruar një pamje të ndryshueshme dhe kontrastive të relievit. Rreth 65% e sipërfaqes së tij përfshin zonat kodrinore dhe malore, ndërsa 35% është e përqendruar në fushat e ulëta. Relievi i Lezhës karakterizohet nga një larmi të jashtëzakonshme, ku ndodhen bregdeti, fusha, kodrat dhe malet, të cilat janë të afërta me njëra-tjetrën në një mënyrë që nuk e gjen në shumë rajone të tjera të vendit. Kjo afërsi krijon një peizazh të bukur dhe të ndryshueshëm, ku çdo hapësirë është e mbushur me histori dhe kulturë. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 413 m, duke e bërë këtë zonë të veçantë për klimën dhe biodiversitetin që ofron qarku i Lezhës, me shumëllojshmërinë e tij të njësive sociale dhe ekonomike, paraqet një strukturë komplekse që mbështetet në disa sektorë kyçë, si bujqësia, turizmi dhe aktivitete tregtare. Bujqësia, si një nga baza të rëndësishme të ekonomisë lokale, ka kontribuar në zhvillimin e komuniteteve dhe ruajtjen e traditave të lashta të kultivimit të tokës, që vazhdojnë të jenë një burim jetese për shumë familje.

Fermerët e zonës prodhojnë një gamë të gjerë produktesh bujqësore, duke përfshirë frutat, perimet dhe produktet e qumështit, të cilat jo vetëm që furnizojnë tregun lokal, por edhe kontribuojnë në eksport. Turizmi është një tjetër sektor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Lezhës. Ky rajon është i njohur për bukuritë natyrore, plazhet e mrekullueshme, dhe peisazhet malore që ofrojnë mundësi për aktivitete të ndryshme në natyrë. Vizitorët gjejnë këtu një mundësi të shkëlqyer për të eksploruar kulturën e pasur shqiptare, e cila është e pasuruar me tradita dhe zakone të ndryshme. Përveç natyrës, Lezha ofron gjithashtu një trashëgimi historike të rëndësishme. Kalaja e Lezhës, një nga monumentet më të njohura të këtij rajoni,

është një dëshmi e ngjarjeve historike të rëndësishme që kanë ndodhur këtu gjatë periudhave të ndryshme. Ajo ka qenë një qendër strategjike dhe simbolike gjatë historisë shqiptare, dhe vizitorët kanë mundësinë të mësojnë rreth këtyre ngjarjeve përmes eksplorimit të këtij monumenti. Rajoni i Lezhës ofron gjithashtu një atmosferë mikpritëse, ku vendasit me shumë dashamirësi pranojnë vizitorët dhe ndajnë me ta traditat dhe historinë e tyre. Kjo bashkëpunim mes kulturave është një faktor thelbësor që e bën këtë vend të veçantë. Për ata që kërkojnë të përjetojnë një përzierje të natyrës, historisë dhe traditave, Lezha paraqet një mundësi të shkëlqyer për t'u zhytur në bukuritë dhe pasuritë e Shqipërisë. Kjo harmoni midis natyrës dhe kulturës, së bashku me aktivitete të shumta turistike, e pozicionon Lezhën si një destinacion tërheqës për vizitorë nga çdo cep i botës.

### **Profili Demografik**

Në vitin 2024, popullsia e qarkut të Lezhës arrinte në një total prej 118,092 banorësh, duke ofruar një pamje të larmishme të përbërjes demografike ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Sipas të dhënave, rreth 70,674 individë jetonin në zona rurale, të cilët kontribuonin në ruajtjen e traditave dhe zakoneve të pasura të këtij rajoni. Këto zona rurale janë shpesh të karakterizuara nga një mënyrë jetese më tradicionale, ku kultura dhe zakonet e përditshme kanë një rëndësi të madhe. Nga ana tjetër, 47,418 banorë jetonin në qytetet e qarkut, ku përqendrohen shumica e shërbimeve dhe infrastrukturës. Gjatë dekadës së fundit, qarku i Lezhës ka përjetuar një rënie të vazhdueshme të popullsisë. Kjo është pjesërisht rezultat i migrimit të qytetarëve drejt qarkut të Tiranës, ku mundësitë për punë dhe zhvillim janë më të shumta. Të dhënat tregojnë se 32% e popullsisë së Republikës së Shqipërisë është përqendruar në qarkun e Tiranës, ndërsa vetëm 4.8% e popullsisë së vendit jeton në qarkun e Lezhës. Kjo tregon një trend të qartë migrimi, ku shumë individë dhe familje zgjedhin të lëvizin drejt kryeqytetit për të gjetur mundësi më të mira. Në përmbljedhje, struktura demografike e qarkut të Lezhës reflekton një ndarje të theksuar midis zonave urbane dhe rurale, me 53% të popullsisë që jeton në zona urbane dhe 47% që përjetojnë jetesën rurale. Kjo situatë përbën një pasqyrë të qartë të sfidave dhe mundësive që përballen banorët e këtij rajoni, ndërsa Shqipëria vazhdon të përjetojë një proces të rëndësishëm urbanizimi dhe transformimi social.



## PERSPEKTIVA GJINORE

### Përkatësia Gjinore në Çështjet e Migracionit dhe Diasporës

Perspektiva gjinore në çështjen e migracionit dhe diasporës përfaqëson një qasje të rëndësishme që eksploron sesi rolet tradicionale gjinore, normat kulturore dhe struktura sociale ndikojnë në përvojat dhe vendimet e individëve që migrojnë. Migracioni nuk është një përvojë uniforme; ajo ndryshon në mënyrë të theksuar sipas gjinisë, duke formuar ndryshe sfidat dhe mundësitë për burrat, gratë dhe individët me identitete gjinore të ndryshme. Historikisht, burrat janë parë si kryesorët që marrin rolin e migrantit, duke u larguar për të kërkuar mundësi ekonomike dhe për të mbështetur financiarisht familjet e tyre. Në këtë kontekst, gratë kanë luajtur rolin e kujdestarëve të familjes, që mbeten pas në vendin e origjinës. Megjithatë, ky model ka evoluar ndjeshëm. Sot, një numër i madh i grave marrin pjesë në proceset migratore, shpesh duke u bërë kryefamiljare dhe duke përmbushur një sërë përgjegjësish që më parë mund të ishin rezervuar për burrat.

Pavarësisht nga kjo rritje e pjesëmarrjes së grave në migracion, përvoja e tyre shpesh mbetet e karakterizuar nga pabarazia dhe diskriminimi. Gratë migrante janë më të prekshme ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, abuzimeve seksuale, shfrytëzimit në tregun e punës dhe dhunës fizike e psikologjike. Në shumë raste, ato përballen me një mungesë të qasjes në shërbime shëndetësore, edukative dhe mbrojtje ligjore, kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të ligjshëm ose frikës nga abuzimeve. Nga ana tjetër, burrat përballen me presione të tjera, shpesh të ndërlidhura me pritshmëritë tradicionale që lidhen me rolin e tyre si "mbajtësit e familjes". Ata mund të përballen me sfida të rënda në tregun e punës, shpesh duke u përfshirë në sektorë me rrezik të lartë dhe paga të ulëta. Për burrat, migracioni mund të nënkuptojë edhe izolim shoqëror dhe mungesë të mbështetjes emocionale, pasi normat gjinore shpesh nuk lejojnë hapjen e tyre për ndihmë. Kur gratë migrojnë, një tjetër aspekt i rëndësishëm është roli që luajnë si faktor ndryshimi në familjet dhe komunitetet e tyre. Shpesh, ato përjetojnë transformim në strukturat gjinore, duke marrë më shumë autonomi dhe fuqi vendimmarrëse në familje dhe duke ndikuar në ndryshimin e normave tradicionale në shoqërinë e origjinës së tyre por edhe në përplasjen që mund të ndeshen për shkak se ndryshimet në një kulturë nuk janë të lehta për tu përballur.

Në diasporë, gjinia luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të individëve. Gratë shpesh kontribuojnë në ekonominë e vendeve pritëse në sektorë

të nënvlerësuar si puna në shtëpi, kujdesi dhe shërbimet, ndërsa burrat në sektorët e vështirë ose punët e rënda ndërtim, transport, riciklim, apo lloje të tjera punësh me kualifikim të ulët ose bazë. Megjithatë, këto punë janë shpesh të padukshme dhe të nënvlerësuar nga shoqëria pritëse. Diaspora mund të ofrojë një hapësirë për ndërtimin e solidaritetit midis grave, si edhe midis burrave, ashtu sikurse edhe midis dy gjinive me njera tjetrën, duke krijuar rrjete mbështetjeje për të ndihmuar njëra-tjetrën të përballen me sfidat e përditshme të jetës së migrantëve.

Në këtë kuadër, perspektiva gjinore zbulon sesi gratë dhe burrat e prekur nga migracioni përjetojnë në mënyra të ndryshme problemet dhe sfidat që lindin nga vendimi për të lëvizur. Kjo qasje e thellë dhe gjithëpërfshirëse i fton profesionistët dhe politikët publike të përqendrohen në njohjen e nevojave dhe përvojave unike të individëve, duke e bërë kështu procesin e hartimit të politikave më të ndjeshëm ndaj gjinisë. Në këtë kontekst, punonjësit socialë luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e sfidave specifike që hasin grupet e ndryshme, duke ofruar një mbështetje të personalizuar dhe duke promovuar zgjidhje që respektojnë diversitetin e përvojave njerëzore. Politikët migratorë gjithashtu duhet të jenë të ndjeshëm ndaj këtyre dinamikave, duke u siguruar që çdo individ, pavarësisht nga gjinia, të ketë akses në mbështetje dhe mbrojtje të përshtatshme. Kjo do të thotë që strategjitë e migracionit duhet të përfshijnë aspekte të ndryshme, si mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi, si dhe promovimi i integritetit dhe mundësive për zhvillim personal dhe profesional.

Bashkia, si institucioni më afërt me qytetarët, ka një rol kyç në procesin e integritetit dhe mbështetjes së individëve që kthehen ose migrojnë në një zonë të re. Ajo shërben si pika e parë e kontaktit për shumë njerëz që kanë nevojë për informacion rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre si qytetarë, duke ofruar shërbime dhe orientim të domosdoshëm për të kaluar nëpër procedurat administrative dhe sociale. Një plan veprimi për migracionin dhe diasporën është mëse i nevojshëm për të adresuar nevojat specifike të grupeve të ndryshëm brenda shoqërisë. Kur flasim për këtë plan, është e rëndësishme të kemi parasysh dhe perspektivën gjinore, pasi burrat dhe gratë përballen me sfida dhe mundësi të ndryshme në kontekstin e migracionit. Kjo qasje gjinore në menaxhimin e migracionit është thelbësore për të siguruar që nevojat dhe përvojat e të gjithë individëve të merren parasysh. Kjo do të thotë që bashkia duhet të angazhohet në krijimin e politikave dhe programeve që jo vetëm që mbështesin integritetin e migrantëve, por gjithashtu promovojnë barazinë gjinore. Kjo përfshin ofrimin e trajnimeve, aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin dhe bashkëjetesën, si dhe informimin rreth të drejtave ligjore dhe mundësive që ekzistojnë për të dyja gjinive. Një komunitet i integruar dhe i

barabartë është një komunitet më i fortë dhe më rezistent, në të cilin çdo individ ka mundësinë për t'u zhvilluar dhe kontribuar në mënyrë të barabartë.

## ANALIZA PESTEL

Analiza e mëposhtme PESTEL është zhvilluar nga grupi i ekspertëve që përgatitën Planin Vendor për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Lezhë për periudhën 2026-2030. Analiza bazohet në informacionin e dhënë nga Bashkia Lezhë, kërkimet, punën studimore dhe të dhënat e gjeneruara nga diskutimet si dhe seminarët gjatë periudhës Shkurt – Maj 2024. Në këtë kontekst, të dhënat janë mundësuar në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe stafin e Bashkisë Lezhë. Evidencat bazohen në faktorët politik, ekonomik, socio-kulturor dhe teknologjikë. Njëkohësisht, ndikimi i faktorëve specifikë në zhvillimet në Bashki u vlerësua në një shkallë me tre faza dhe parashikimi i faktorëve me vlersimin pozitiv, nuk ka ndryshim dhe negative. Më poshtë, gjendet Tabela 1 me të dhënat e gjeneruara për Bashkinë Lezhë.

**Tabela 1:** Analiza PESTEL

FAKTORËT	Fuqia e ndikimit në zhvillimin e bashkisë	Parashikimi i drejtimit të ndikimit të faktorëve
<b>FAKTORËT POLITIK</b>		
Stabiliteti Politik	3	↑
Shpërndarja strukturore e fondeve të BE	3	↑
Bashkëpunimi ndërkombëtar	2	↑
Mbështetja për zhvillimin rajonal	1	↑
Taksat Vendore	3	↑
Niveli i decentralizimit	1	↑
Rregulloret mjedisore	1	→
Kapacitetet e burimeve njerëzore në nivel vendor	3	↑
Zhvillimi i partneritetit publik privat	2	↑
<b>FAKTORËT EKONOMIKË</b>		
Gjendja e ekonomisë	1	↑
Dinamika e rritjes ekonomike	3	↑
Gjendja e financave publike	1	↑
Zhvillimi i industrisë së turizmit	3	↑
Tendencat ekonomike të brendshme	2	↑
Ndikimi dhe niveli i investimeve të huaja	1	↑

Vendndodhja gjeografike	3	↑
Konkurrenca nga njësitë e tjera territoriale	1	→
Cilësia e politikës ekonomike qendrore	2	↑
Niveli mesatar i të ardhurave	1	↑
Kostot e punës	2	→
Shkalla e papunësisë	3	↓

#### FAKTORËT SOCIAL-KULTURORE

Roli i burrave dhe grave në shoqëri	1	↑
Emigracioni i punëtorëve të kualifikuar	3	↓
Imigrimi i punëtorëve të pakualifikuar	3	↓
Ndërgjegjësimi ekologjik	2	↑
Pabarazitë sociale	2	↓
Zhvillimi i kapitalit njerëzor	3	↑
Lëvizshmëria e punëtorëve	3	↑
Tendencat e stilit të jetesës	2	→
Nivelet e përgjithshme të aspiratës së njerëzve	1	↑
Zhvillimi i Organizatave Joqeveritare	3	→
Fondet për kujdesin shëndetësor dhe social	1	↑
Shkalla e rritjes së popullsisë	1	↑
Plakja e popullsisë	3	↓
Identiteti local	2	↑

#### FAKTORËT TEKNOLOGJIKË

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit (technik).	2	↑
Fondet për projektet e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit	1	↑
Automatizimi	1	→
Zhvillimi i mediave sociale	3	↑
Zhvillimi i inovacionit	3	↑
Zhvillimet e fundit teknologjike	1	↑
Akses në teknologjitë moderne	2	↑
Zhvillimi i tele-ëork	2	↑

*\*Legjenda e Tabelës*

**Fuqia e ndikimit:**

- ❖ 3-e lartë;
- ❖ 2-mesatare;
- ❖ 1-e ulët

**Parashikimi i drejtimit:**

- ❖ pozitive↑;
- ❖ ska ndryshim→;
- ❖ negative↓

---

Analiza PESTEL e realizuar për bashkinë Lezhë, nga grupi i punës ka identifikuar faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin e rajonit, duke i klasifikuar në katër drejtime kryesore: Faktorët Politik, Ekonomik, Social Kulturor dhe Teknologjik. Kjo analizë ofron një pasqyrë të thellë mbi sfidat dhe mundësitë që përballen banorët dhe autoritetet e bashkisë.

Ndër **faktorët politikë** me më shumë ndikim janë stabiliteti politik dhe aftësitë e burimeve njerëzore vendase dhe taksat vendore. Stabiliteti politik ka fuqi të lartë ndikimi dhe me prirje pozitive në proceset e vendimmarrjes, ndërsa forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore shihet si një mënyrë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve. Taksat vendore janë portofoli i bashkive dhe si të tilla nuk mund të mos shihen apo të mos kenë ndikim, prandaj shpesh bashkitë për shkak të mungesës se instrumentave të duhur menaxherial nuk realizojnë mbledhjen e taksave në nivelet e pritshme.

Nëpërmjet **menaxhimit të shëndoshë fiskal** dhe politikave tatimore efikase, bashkia kërkon të balancojë përgjegjësitë financiare me krijimin e një mjedisi mbështetës për bizneset dhe banorët vendas. Praktikant transparente të administratës tatimore ndihmojnë në ndërtimin e besimit dhe llogaridhënies brenda komunitetit. Duke i menaxhuar me përgjegjësi këto të ardhura, Bashkia Lezhë synon të rrisë cilësinë e jetës së banorëve dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Në nivel mesatar ndikimi janë **shpërndarja e fondeve të Bashkimit Evropian** dhe zhvillimi i partneriteteve publike-private janë gjithashtu faktorë të dukshëm, me ndikim të moderuar aktualisht, por pritet të rritet. Shfrytëzimi efektiv i këtyre fondeve parashikohet të çojë në shërbime më konkrete dhe të përmirësuara. Për më tepër, bashkëpunimi me bizneset private në hartimin e politikave të migracionit dhe diasporës shihet si një qasje premtuese për rritjen e ardhshme. Faktorët e tjere mjedisor, zhvillimi rajonal apo decentralizimi janë më pak ndikues.

**Zhvillimi i turizmit** në Bashkinë Lezhë ka një potencial të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe pasurimin kulturor. Me trashëgiminë e saj të pasur historike, peisazhet mahnitëse natyrore dhe afërsinë me detin Adriatik, Lezha ofron një gamë të larmishme atraksionesh për vizitorët që të eksplorojnë. Bashkia është e përkushtuar të shfrytëzojë këto asete për të tërhequr turistë

dhe për të stimuluar bizneset lokale. Prandaj vendoshja gjeografike, dinamikat e rritjes ekonomike, turizmi dhe papunësia kanë ndikimin më të lartë ndër këta faktorë.

Përpyekjet përqendrohen në **përmirësimin e infrastrukturës**, rritjen e opsioneve të akomodimit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme turistike që ruajnë integritetin natyror dhe kulturor të rajonit. Duke investuar në zhvillimin e turizmit, Bashkia Lezhe kërkon të krijojë mundësi të reja punësimi, të nxisë gjenerimin e të ardhurave dhe të shfaqë sharmin unik të rajonit në botë. Dinamika e rritjes ekonomike në Bashkinë Lezhë pasqyron një peizazh të formuar nga sektorë të ndryshëm dhe mundësi në zhvillim. Si një rajon bregdetar Lezha përfiton nga pozicioni i saj strategjik, duke lehtësuar aktivitetet tregtare dhe turistike.

Ndikim mesatar kanë faktorët si tendencat ekonomike të brendshme, cilësia e politikës qendrore dhe kostot e punës që veprojnë në drejtime të ndryshme.

**Investimet e huaja** kanë premtimin për të katalizuar transformimin ekonomik në Bashkinë Lezhë, duke ofruar mundësi për krijimin e vendeve të punës, transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin e infrastrukturës, edhe pse janë kategorizuar me më pak ndikim sipas nivelit actual të tyre. Partneritetet me firmat e huaja sjellin jo vetëm kapital financiar, por edhe ekspertizë dhe rrjete globale, të cilat mund të kontribuojnë në qëndrueshmërinë ekonomike dhe konkurrencën afatgjatë të bashkisë. Duke promovuar dhe lehtësuar në mënyrë aktive investimet e huaja, Bashkia Lezhe aspiron të shfrytëzojë burimet e jashtme për zhvillim dhe prosperitet të qëndrueshëm, duke përfituar si komunitetet lokale ashtu edhe aktorët globalë.

**Faktorët social-kulturor** të cilët kanë ndikimin më të lartë janë emigrimi i punëtorëve të kualifikuar që paraqet sfida dhe mundësi për zhvillimin e kapitalit njerëzor të Bashkisë Lezhë. Ndërsa largimi i individëve të aftë mund të çojë në një largim të përkohshëm të trurit, ai gjithashtu nënkupton potencialin për angazhimin e diasporës dhe transferimin e njohurive, në një nivel edhe më të lartë dhe inovator. Lezha synon të trajtojë këtë fenomen duke zbatuar strategji për të mbajtur dhe tërhequr talentet, si investimi në programe arsimore dhe formimi profesional të përshtatura për nevojat lokale. Përveç kësaj, nxitja e një mjedisi mbështetës për sipërmarrjen dhe inovacionin mund të nxisë individët e aftë të qëndrojnë ose të kthehen për të kontribuar në rritjen e bashkisë. Duke menaxhuar në mënyrë proaktive emigracionin e punëtorëve të kualifikuar dhe duke ushqyer kapitalin njerëzor, Bashkia Lezhe përpiqet të kultivojë një fuqi punëtore të kualifikuar, e aftë për të nxitur zhvillimin dhe prosperitetin e qëndrueshëm ekonomik.

**Krijimtaria rajonale** luan një rol kryesor në formësimin dhe ruajtjen e identitetit lokal të Bashkisë Lezhë. Nëpërmjet artit, kulturës dhe trashëgimisë, banorët shprehin traditat, vlerat dhe historitë e tyre unike, duke nxitur një ndjenjë përkatësie dhe krenarie brenda komunitetit. Lezha feston diversitetin e saj kulturor përmes festivaleve, eventeve dhe përpjekjeve artistike që shfaqin talentet dhe krijimtarinë e saj. Duke ushqyer krijimtarinë rajonale dhe duke përqafuar trashëgiminë e saj kulturore, Bashkia Lezhe nderon të kaluarën e saj, ndërsa parashikon një të ardhme të gjallë dhe gjithëpërfshirëse, ku krijimtaria shërben si një katalizator për kohezionin social, inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Sigurimi i fondeve të mjaftueshme** për nismat e kujdesit shëndetësor social është një prioritet kritik për Bashkinë Lezhë, duke garantuar mirëqenien dhe dinjitetin e banorëve të saj. Me një popullsi të plakur dhe nevojat në zhvillim të kujdesit shëndetësor, investimi në programet e shëndetit social është thelbësor për promovimin e barazisë dhe aksesit në shërbimet thelbësore. Lezha njih rëndësinë e shpërndarjes së burimeve për të mbështetur popullatat e cënueshme, duke përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta. Plakja e popullsisë dhe identiteti local luajnë një rol evident në këtë bashki pasi paraqesin një ndryshim të rëndësishëm demografik për Bashkinë Lezhë, duke kërkuar strategji proaktive për të adresuar nevojat në zhvillim të banorëve të saj Stili i jetesës, pabarazitë sociale janë element me ndikim mesatar. Ndërsa ndikimin më të ulët e kanë aspiratat njerëzore të zonës dhe shkalla e rritjes së popullsisë.

Me rritjen e jetëgjatësisë dhe rënien e nivelit të lindjeve nënvizon rëndësinë e zhvillimit të **politikave dhe shërbimeve miqësore ndaj moshës** që plotësojnë nevojat specifike të të rriturve të moshuar, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, strehimin dhe sistemet e mbështetjes sociale. Nëpërmjet planifikimit të kujdesshëm financiar dhe përpjekjeve bashkëpunuese, Bashkia Lezhe përpiqet të ndërtojë një sistem shëndetësor elastik që ka prioritet mirëqenien e plotë të qytetarëve të saj.

**Faktorët teknologjik** e japin ndikimin përmes këtyre elementëve më të fuqishëm për zonën: Zhvillimi i infrastrukturës së transportit publik është një prioritet kyç për Bashkinë Lezhë, thelbësor për rritjen e lëvizshmërisë, lidhjes dhe qëndrueshmërisë brenda qarkut. Duke njohur rëndësinë e rrjeteve efikase të transportit në nxitjen e rritjes ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, bashkia është e përkushtuar të investojë në modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të transportit public. Duke i dhënë përparësi zhvillimit të infrastrukturës së transportit publik, Bashkia Lezhe kërkon të rrisë aksesin, përbalueshmërinë dhe komoditetin

si për banorët ashtu edhe për vizitorët, duke nxitur një rritje të qëndrueshme dhe prosperitet për komunitetin.

Zhvillimi i **mediave sociale** paraqet një mundësi dinamike për bashkinë Lezhe për t'u angazhuar me banorët e saj, për të promovuar iniciativat lokale dhe për të rritur lidhjen e komunitetit, si e tillë ushtron ndikim të konsiderueshëm dhe pozitiv për bashkinë. Duke njohur përdorimin e gjerë të platformave sociale, bashkia po i shfrytëzon këto kanale për të shpërndarë informacion, për të kërkuar komente dhe për të nxitur dialogun për çështje të rëndësishme qytetare. Duke ruajtur praninë aktive të mediave sociale nëpër platforma si Facebook, Instagram dhe Tëitter, Lezha synon të arrijë demografi të ndryshme dhe të lehtësojë komunikimin e dyanshëm me votuesit. Bashkia Lezhe po shfrytëzon fuqinë e mediave sociale për të ndërtuar lidhje më të forta, për të përforcuar zërat dhe për të nxitur ndryshime pozitive brenda komunitetit.

**Inovacioni** si faktori i tretë ndikues, qëndron si një gur themeli i vizionit të Bashkisë Lezhë për zhvillim të qëndrueshëm dhe prosperitet ekonomik. Duke përqafuar një kulturë të krijimtarisë dhe të menduarit përpara, bashkia po nxit në mënyrë aktive një mjedis të favorshëm për inovacion në sektorë të ndryshëm, dhe duke siguruar akses te plotë në to. Automatizimi, kërkimi shkencor shifen me larg potencialit aktual të zonës. Qoftë në bujqësi, turizëm apo energji të rinovueshme, Bashkia Lezhe njeh fuqinë transformuese të inovacionit në adresimin e sfidave urgjente dhe si një nxitës progresi. Lezha është e gatshme të formësojë një të ardhme të përcaktuar nga elasticiteti, gjithëpërfshirja dhe prosperiteti për të gjithë.

## QËLLIMI I PLANIT VENDOR

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën është të ndërtojë një infrastrukturë të përshtatshme për të menaxhuar me efikasitet dhe koordinim e çështjeve të migracionit dhe diasporës, duke i bërë ata faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik lokal. Bashkia Lezhë synon të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga vendndodhja e tyre, dhe punon për të nxitur përfshirjen dhe integrimin e tyre me të drejta të plota dhe të barabarta. Misioni i Bashkisë është të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve dhe lehtësirave në realitetin ekonomiko-social për qytetarët. Për të arritur këtë, është e nevojshme një menaxhim i përmirësuar i burimeve vendore, një planifikim strategjik më i fuqishëm, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, si dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Në thelb, qeverisja e mirë dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë objektivat kryesore që pushteti vendor duhet të sigurojë për mirëqenien dhe përparimin e komunitetit lokal.

## VIZIONI I PLANIT VENDOR TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Bashkia Lezhe synon përmes vizionit që të krijojë kushte optimale për diaspora dhe emigrantët, duke i inkurajuar ata të investojnë në vendlindje. Kjo nismë thekson rëndësinë e sigurisë ekonomike dhe politike, e cila është thelbësore për të motivuar investimet e diasporës. Duke ofruar mundësi për zhvillim të qëndrueshëm, do arrijmë të forcojmë lidhjet me komunitetet jashtë dhe të promovojmë një zhvillim që përfshin të gjithë, duke siguruar një të ardhme më të mirë për brezat e ardhshëm. Investimet e diasporës jo vetëm që ndihmojnë në rritjen ekonomike, por gjithashtu kontribuojnë në forcimin e identitetit kombëtar dhe në krijimin e mundësive për të rinjtë në vend.

*-Bashkia Lezhë në 2030-*



*“Siguri për zhvillim të qëndrueshëm dhe investime nga diaspora & emigrantët”*

## OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR Lezhë

**Bashkia Lezhë** do i realizojë detyrat funksionale dhe ligjore për çështjet e diasporës dhe migracionit, në mënyrë që të arrijë objektivat e parashikuara në 3 fusha veprimi si më poshtë:

**Tabela 2:** Objektivat e Planit Vendor Lezhë

<b>Fusha A.</b> Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.	
Objektivat	<b>A.1</b> Organizim funksional dhe operativ i strukturës vendore për migracionin dhe diasporën.
	<b>A.2</b> Rritja e aftësive profesionale të specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit
	<b>A.3</b> Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe afatgjata me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.
<b>Fusha B.</b> Shërbimet sociale publike me bazë komunitare	
Objektivat	<b>B.1</b> Informim i vazhdueshëm në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë.
	<b>B.2</b> Përfshirje dhe rintegrim i migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës nëpërmjet garantimit dhe aksesit në shërbime sociale.
<b>Fusha C.</b> Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit local.	
Objektivat	<b>C.1</b> Përcaktimi dhe shpërndarja e nevojave vendore të komunitetit me diasporën dhe migrantët.
	<b>C.2</b> Garantim i ndihmës për të përmirësuar investimet publike dhe private nga komuniteti diasporës dhe migrantët e kthyer.

Për realizim sa më efektiv, fushat e veprimit kanalizojnë problematikat dhe proceset e tjera të veprimtarisë së bashkisë në objektiva, të cilat përkthehen në masa konkrete të matshme, të realizueshme dhe të monitorueshme.

## FUSHA E VEPRIMIT A

Menaxhimi efektiv i çështjeve të diasporës dhe migracionit është një nga faktorët kyç për zhvillimin ekonomik dhe social të një komuniteti. Strukturat vendore luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e politikave dhe masave që adresojnë nevojat e këtij grupi, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për integrimin dhe përfitimin nga potenciali i tyre. Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të këtyre strukturave, si në nivel institucional ashtu edhe në nivel operativ, është një domosdoshmëri për të siguruar që përfaqësimi dhe mbështetja ndaj diasporës dhe migrantëve të rikthyer të jetë sa më efektive. Kjo përfshin forcimin e bashkëpunimit midis bashkisë Lezhë, organizatave joqeveritare (OJF-ve), dhe institucioneve qendrore për të siguruar që politikat dhe veprimtaritë të përputhen me nevojat e komuniteteve migrante. Për të arritur këtë, është thelbësore të zbatohet një qasje e integruar që ndihmon në krijimin e strukturave të qëndrueshme për menaxhimin e lidhjeve me diasporën. Bashkia Lezhë mund të përfitojë nga partneritetet me OJF-të që punojnë me migrantët dhe diasporën, duke zbatuar projekte të përbashkëta në fusha si punësimi, edukimi dhe zhvillimi ekonomik.

**Panairi i Krenarisë** do të shërbejë si një platformë për të ekspozuar historitë e suksesit të emigrantëve të kthyer dhe për të treguar mundësitë investuese dhe bashkëpunuese në Lezhë. Kjo nismë jo vetëm që do të promovojë rolin e rëndësishëm të diasporës në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit, por gjithashtu do të forcojë lidhjet midis emigrantëve të kthyer dhe institucioneve vendore, duke u ofruar atyre një mjedis për të shkëmbyer përvoja dhe për të promovuar mundësi të reja. Krijimi i një baze të dhënash që përfshin informacione të plota për institucionet dhe organizatat që lidhen me çështjet e migracionit, do të jetë në vëmendje. Kjo bazë të dhënash duhet të përfshijë kontakte, aktivitete, nevoja dhe mundësi për bashkëpunim, duke e bërë më të lehtë koordinimin midis aktorëve të ndryshëm. Platformat e dedikuara në faqet zyrtare të bashkisë dhe organizatave do të lehtësojnë komunikimin dhe koordinimin ndërmjet institucioneve lokale, qendrore dhe organizatave ndërkombëtare. Në përputhje me angazhimin për mbështetjen e grupeve më të marginalizuara, do të implementohen aktivitete që promovojnë të drejtat e grave migrante, përfshirjen e tyre në programe të ndryshme.

**Tabela 3: Fusha e Veprimit A**

**Fusha e veprimit A.**

**Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit:**

Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor

Krijimi i strukturave të qëndrueshme për menaxhimin e lidhjeve me diasporën dhe migrantët.

Masat	Periudha e zbatimit	Struktura përgjegjëse në bashki	Institucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm	
<b>Objektivi 1.1:</b> Organizim funksional dhe operativ i strukturës vendore për migracionin dhe diasporën.	a) Hartim i përshkrimit të punës për specialistin /përgjegjës për çështjet e migracionit dhe diasporës.	2026	Dr. Burimeve Njerëzore/ Dr. Projekteve Strategjike	MB MCPV Organizata	Përshkrimi i punës i aproruar	1 akt
	b) Hartimi dhe miratimi i procedurave standarte të punës për trajtimin e rasteve të migrantëve dhe diasporës.	2026 - 2027	Dr. Projekteve Strategjike/ Dr. e Shërbimit dhe Kujdesit Social	MB MCPV Organizata	Procedura të aprovuara	1 vendim
	c) Prodhimi i materialeve informuese dhe promovuese për Strukturën Vendore të Migracionit dhe Diasporës	2026 - 2027	Dr. Projekteve Strategjike	MB MCPV Organizata	Materiale të prodhura	Deri në 5000 kopje
	d) Validim dhe përditësimi i databazës së të dhënave për organizatat e diasporës dhe emigrantët.	2026 - 2030	Dr. Projekteve Strategjike/ Dr. e Shërbimit dhe Kujdesit Social	AKD AKPA Organizata	Databazë e plotë	1-Vlera bazë 0 2-Matet nga 0
<b>Objektivi 1.2:</b> Rritja e aftësive profesionale të specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit	a) Organizimi i takimeve periodike për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira si dhe ndarjen e informacionit me institucione publike, private dhe organizata joqeveritare.	2026 - 2030	Dr. Projekteve Strategjike	MB Organizata	Kalendar periodik i takimeve	Nr i takimeve dhe rezultatet e arritura
	b) Raportim i vazhdueshëm pranë Sekretariatit Teknik të Migracionit lidhur me zbatimin e masave që Bashkia implementon në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2030.	2026 - 2030	Dr. Projekteve Strategjike	MB	Raportimet	Nr. i raportimeve

	c) Pjesëmarrja aktive dhe e vazhdueshme e specialistëve në trajnime, workshope për çështjet e migracionit dhe diasporës.	2026 - 2030	Dr. Projekteve Strategjike/ Dr. e Shërbimit dhe Kujdesit Social	MB ASPA Organizata	Kalendari i trajnimeve	Nr i trajnimeve; Nr i specialisteve të trajnuar.
	d)Organizimi i trajnimve për trajtimin e çështjeve të migracionit dhe diasporës me institucionet lokale nga strukturat e bashkisë	2026 - 2028	Administrata e bashkisë	Organizata	Kalendar periodik i takimeve	Nr i takimeve /organizimeve
<b>Objektivi 1.3:</b>	a)Planifikimi dhe koordinimi i tryezës vjetore konsultative me diasporën.	2026 - 2030	Kabineti/ Administrata e bashkisë	AKD, MB	Rritja e identifikimit të diasporës	4 takime konsultative
Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe afatgjata me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.	b)Krijimi i Këshillit Konsultativ për Diasporën dhe Migrantët.	2025 - 2028	Kabineti/ Administrata e bashkisë	AKD, MB	Adresimi i ideve të diasporës në politika lokale	Akti i ngritjes së këshillit
	c)Ndërmarrja e iniciativave dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta me organizatat e shoqërisë civile.	2026 - 2030	Dr. Projekteve Strategjike/ Dr. e Shërbimit dhe Kujdesit	Organizata	Zbatimi i projekteve në vit (min. 1 në vit).	Nr. i projekteve
	d)Organizimi i një panairi të dedikuar me qëllim promovimin e historiave të suksesit të emigrantëve të kthyer dhe mundësive që ofrohen për ta.	2026 - 2030	Kabineti/ Administrata e bashkisë	Organizata AKD	Njohja me mundësitë e ndryshme, përvoja të reja dhe motivim.	Nr i panairove të organizuara. Nr. i rasteve të suksesit të prezantuara.

## FUSHA E VEPRIMIT B

Shërbimet sociale dhe ekonomike për migrantët e kthyer dhe diasporën përbëjnë fushën e dytë të ndërhyrjes për ndërtimit e një mjedisi mbështetës dhe gjithëpërfshirës. Duke u fokusuar në fuqizimin e tyre ekonomik dhe shoqëror, dhe duke ofruar një qasje të qartë dhe të lehtë në shërbimet publike, ky plan do të ndihmojë në integrimin e suksesshëm të këtyre grupeve në komunitetin lokal. Duke u bazuar në nevojat specifike të tyre, është e rëndësishme të ofrohen shërbime gjithëpërfshirëse që lehtësojnë riintegrimin dhe përfshirjen e tyre në jetën shoqërore dhe ekonomike. Për të arritur këtë qëllim, është thelbësore krijimi i një rrjeti mbështetës në nivel lokal, që përfshin jo vetëm institucionet publike, por edhe organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat.

Ky rrjet do të jetë në funksion të organizimit të takimeve të rregullta me organizata lokale që kanë eksperiencë në punën me migrantët e kthyer. Këto takime synojnë të lehtësojnë bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë organizatat që trajtojnë çështje të punësimit dhe vetëpunësimit. Qëllimi është krijimi dhe zbatimi i programeve të përbashkëta që promovojnë punësimin e personave të rikthyer nga migracioni, si dhe mundësi për vetëpunësim. Përmes këtyre takimeve, mund të identifikohen hapësira të reja për trajnim profesional, mbështetje financiare për biznese të vogla dhe mundësi të tjera që ndihmojnë këta individë të përfitojnë nga eksperiencat dhe aftësitë e fituara gjatë kohës që kanë qenë jashtë vendit.

Gratë që kthehen nga migracioni shpesh përballen me sfida të shumta, përbëjnë një komponent të rëndësishëm të planit për të cilat do të realizohet referimi në programe të nxitjes së punësimit. Përmes bashkëpunimit me organizata të ndryshme dhe programe të veçanta, gratë do të kenë mundësi të përfitojnë nga trajnimet, mentorimi dhe mbështetja për të filluar ose për të rritur kapacitetet e tyre profesionale. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi ekonomik i grave të rikthyera është kyç për zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Një pjesë tjetër e rëndësishme është ndërgjegjësimi mbi të drejtat e grave migrante. Aktivitete promovuese, fushata ndërgjegjësimi në fushën e shërbimeve publike dhe sociale vendore, me synimin kryesor që të sigurohet një komunikim dhe informim të vazhdueshëm për diasporën dhe migrantët e rikdo të krijohet një hapësirë ku gratë migrante do të mund të informohen mbi të drejtat e tyre dhe mbështetjen ligjore dhe sociale që kanë në dispozicion. Një udhërrëfyes praktik për shërbimet e ofruara për migrantët e kthyer do të jetë një instrument kyç për orientimin e tyre drejt mbështetjes që mund të marrin në nivel lokal dhe kombëtar. Ky udhërrëfyes do të përmbajë informacion të detajuar

